



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____prot.

Durrës, më _____.____.2023

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[14/04/2023]

Drejtuar: **HYDRO-ENG CONSULTING me NIPT M11417503F** me Adrese: Durrës Rruga Ahmet Ramzoti, Lagjja nr.18, Rajoni nr.5, nr.Pasurie 29/70+1-211, Zona kadastrale 8511

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-61983-03-09-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mbikqyrje, Rehabilitimi i zones qe preket nga zgjerimi territorial i varrezave te Qytetit te Durrësit”,

Fondi limit: 1’728’000 (një milion e shtatëqind e njëzetë e tetë mijë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 720 (ditë)

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [13.mars.2023] [NR.24]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. GB CIVIL ENGINEERING me NIPT L51825011V me vlerë të ofertës 1’539’428.57 (një milion e pesëqind e tridhjet e nëntë mijë e katerqind e njezet e tetë presje pesëdhjetë e shtatë) lekë.
2. DAAM me NIPT L72205042F + NET-GROUP me NIPT L72023002P, me vlerë të ofertës 1’551’292.69 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjet e dy presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë

3. PROJECT DALUZ 2019 me NIPT L92112031B + M.A.K STUDIO me NIPT L01422017O, me vlerë të ofertës 1'566'857.14 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje katërmbëdhjetë) lekë
4. NOVATECH STUDIO me NIPT L01717030C, me vlerë të ofertës 1'584'000.00 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë
5. HYDRO-ENG CONSULTING me NIPT M11417503F, me vlerë të ofertës 1'591'680.00 (një milion e pesëqind e nëntëdhjet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Për ofertuesin **GB CIVIL ENGINEERING me NIPT L51825011V**, me vlerë të ofertës **1'539'428.57 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik **GB CIVIL ENGINEERING**:
Nuk permbush piken 2.1.a te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas Shtojces 9. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht, konstatohet se oferta ekonomike e paraqitur prej 1'539'428.57 lekë është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Në këto kushte, mbështetur në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim, pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”. Ky arsyetim është mbështetur edhe në shkresat me nr. 5585 prot., datë 25.07.2017, dhe nr. 13565, datë 06.11.2017, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Për ofertuesin **DAAM me NIPT L72205042F + NET-GROUP me NIPT L72023002P**, me vlerë të ofertës **1'551'292.69 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik **DAAM + NET-GROUP**:
Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht, konstatohet se oferta ekonomike e paraqitur prej 1'551'292.69 lekë është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Në këto kushte, mbështetur në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim, pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.
Ky arsyetim është mbështetur edhe në shkresat me nr. 5585 prot., datë 25.07.2017, dhe nr. 13565, datë 06.11.2017, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

3. Për ofertuesin **PROJECT DALUZ 2019 me NIPT L92112031B + M.A.K STUDIO me NIPT L01422017O**, me vlerë të ofertës **1'566'857.14 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik **PROJECT DALUZ 2019 + M.A.K STUDIO**:

Nuk permbush piken 2.1.a te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, pasi operatori ekonomik M.A.K STUDIO nuk ka paraqitur Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas Shtojces 9. Ndersa operatori ekonomik PROJECT DALUZ 2019, ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur, ne *“Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik”*, nuk ka vetedeklaruar Bashkimin e Operatoreve ekonomik. Gjithashtu, ne seksionin *“B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”*, ne piken 6 ka cituar se *“Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”*; dhe ne piken 7 deklaron se *“nuk është konsultuar, nuk ka komunikuar, nuk ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedure prokurimi”*, ne kundërshtim me ofertën e bashkimit te operatoreve ekonomik te paraqitur ne kete procedure.

Nuk permbush piken 2.1.b te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes. Sigurimi i ofertes i paraqitur, i referohet Autoritetit Kontraktor Banka e Shqiperise.

Nuk permbush piken 2.2.b te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku citohet se *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, pasi operatori ekonomik PROJECT DALUZ 2019 nuk ka paraqitur bilancin vjetor per vitin financiar 2021.

Nuk permbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, ku citohet *“Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 345’600 lekë”*, pasi operatori ekonomik M.A.K STUDIO nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.

Nuk permbush piken 2.3.2 te Kapacitetit Teknik, per paraqitjen e licences profesionale te shoqerise, pasi licenca e paraqitur nga operatori ekonomik M.A.K STUDIO ka perfunduar vlefshmerine e saj ne daten 14.11.2022.

Nuk permbush piken 2.3.3 te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: Inxhinier Ndertimi/Hidroteknik 1 (një); Inxhinier Gjeodet 1 (një); Inxhinier Gjeolog 1 (një); Inxhinier Mjedisi 1 (një)”*, pasi asnje nga operoret ekonomik pjese e BOE nuk ka vetedeklaruar inxhinier gjeolog dhe inxhinier mjedisi.

Nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Kontrollor Cilesie 1 (një); Inxhinier Ndertimi/Hidroteknik 1 (një); Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) 1 (një); Inxhinier Gjeoteknik 1 (një); Inxhinier Topograf 1 (një)”*, pasi asnje nga operoret ekonomik pjese e BOE nuk ka vetedeklaruar, inspektor te sigurimit dhe shendetit ne pune, inxhinier gjeoteknik dhe inxhinier topograf.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht, konstatohet se oferta ekonomike e paraqitur prej 1’566’857.14 lekë është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Në këto kushte, mbështetur në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*,

mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim, pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Ky arsyetim është mbështetur edhe në shkresat me nr. 5585 prot., datë 25.07.2017, dhe nr. 13565, datë 06.11.2017, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. Për ofertuesin NOVATECH STUDIO me NIPT L01717030C, me vlerë të ofertës 1'584'000.00 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik NOVATECH STUDIO:

Nuk permbush piken 2.3.4 të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Kontrollor Cilesie 1 (një); Inxhinier Ndertimi/Hidroteknik 1 (një); Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) 1 (një); Inxhinier Gjeoteknik 1 (një); Inxhinier Topograf 1 (një)*”, pasi nuk ka vetedeklaruar inxhinier gjeoteknik në permbushje të këtij kriteri.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht, konstatohet se oferta ekonomike e paraqitur prej 1'584'000.00 lekë është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Në këto kushte, mbështetur në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim, pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Ky arsyetim është mbështetur edhe në shkresat me nr. 5585 prot., datë 25.07.2017, dhe nr. 13565, datë 06.11.2017, nga Agjencia e Prokurimit Publik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **HYDRO-ENG CONSULTING me NIPT M11417503F** dhe adrese: Durres Rruga Ahmet Ramzoti, Lagjja nr.18, Rajoni nr.5, nr.Pasurie 29/70+1-211, Zona kadastrale 8511, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1'591'680.00 (një milion e pesëqind e nënëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë:[*Bashkia Durres, Njesia e Prokurimit, njesia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*NUK KA TE KLASIFIKUAR TJETER PERVEC KETIJ OPERATORI*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Emiriana Sako